



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 2036 prot.

Fier, më 13.02.2026

DEGJESE PUBLIK

Për zhvillimin e dëgjësës publike me grupet e interesit për hartimin e Planit Social ,dhe planit te Barazise Gjinore të Bashkisë Fier.

Në zbatim të kuadrit ligjor për konsultimin publik dhe me qëllim përfshirjen aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse, Bashkia Fier njofton organizimin e një dëgjese publike në kuadër të hartimit të Planit Social dhe planit te Barazise Gjinore të Bashkisë Fier .

Kjo dëgjese synon të mbledhë mendime, sugjerime dhe rekomandime nga grupet e interesit, përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile, institucione publike, organizata joqeveritare, grupe vulnerabël, profesionistë të fushës sociale dhe qytetarë të interesuar, me qëllim përmirësimin e politikave dhe shërbimeve sociale në territorin e bashkisë.

Detajet e dëgjësës publike janë si më poshtë:

Data: 19.02.2026

Ora: 11.30

Vendi: Salla e Keshillit Bashkiak

Të gjithë të interesuarit janë të ftuar të marrin pjesë dhe të kontribuojnë me opinionet e tyre, të cilat do të merren në konsideratë gjatë hartimit të dokumentit përfundimtar të Planit Social.

Materiali do te behet publike dhe ne faqen zyrtare te Bashkise Fier.

Kontributi juaj është i rëndësishëm për ndërtimin e një plani social gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave reale të komunitetit.

KRYETAR I BASHKISË
ARMANDO SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ZV.KRYETAR I BASHKISË

Mirela Pitushi

